



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:225596

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06080955

AC-I-23-0226

Në ankesën e

Paditësi

S A, Prizren.

Kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH "Famipa", Prizren (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-13-1868 të datës 16 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 gusht 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-13-1868 i datës 16 mars 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike:

Me 27 shtator 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), PRZ024 – 0021 të datës 26 gusht 2013 me të cilin i ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës, në shumë prej 1,080.00 €. AL e kishte refuzuara kërkesën me arsyetim se paditësi nuk ishte punëtor aktiv në kohën e privatizimit të NSH-së. Paditësi ka pohuar se ka qenë punëtor i NSH "Famipa" në Prizren (në likuidim) dhe ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të ndërmarrjes. Paditësi kërkon që gjykata pas shqyrtimit të merr vendim në mënyrë që kërkesat e tij të aprovohet dhe të obligohet AKP-ja që t'ia paguaj shumën prej $7 \times 180 \text{ €} = 1,260.00 \text{ €}$ në emër të ndërprerjes së parakohshme të kontratës, në emër të pagave të punonjësve të kufizuar në tre paga $3 \times 180 = 540.00 \text{ €}$ si dhe ka kërkuar pagat e papaguara për muajt: shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2011 të paguhen në shumën prej $4 \times 180 \text{ €}$ e gjithashtu edhe për 15 ditë punë në muajin shtator të po atij viti e në shumën prej 137.14 €, e të gjitha këto shuma, në një total të përgjithshëm prej 2,614.94€. Paditësi kërkon nga gjykata që të priset vendimi i AL PRZ024 – 0021, datë 26 gusht 2013, të aprovohet ankesa e tij me të cilën kërkon që AL t'ia paguaj pagat e papaguara në përlllogaritjet si më lartë dhe si përfundim kërkon të obligohet AL që në afatin prej 15 ditësh ta pajisë paditësin me vendimin për realizimin e pagave të papaguara.

Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar dëshmitë në kopje si: vendimin e atakuar nr. PRZ024-0021, datë 26 gusht 2013, Kërkesën për kompensimin e pagave, Formularin për dorëzimin e kërkesës në procedurë të likuidimit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës nr. PRZ024/125 të datës 16 shtator 2011 dhe Librezën e punës.

Me 25 korrik 2014, e paditura parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Po ashtu, e paditura pohoi se në lidhje me kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme thekson se neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 i jep të drejtë për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës vetëm atyre punonjësve të cilët janë pushuar nga puna si pasojë ose në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP. Më tej e

paditura pohoi se paditësi nuk ishte pjesë e listë pagesës së gjashtë muajve të fundit para privatizimit, andaj nuk është privatizimi i NSH nga ana e AKP që ka shkaktuar pushimin e tij nga puna. E paditura ndër të tjera potencon se parashtruesi ka pretenduar që ka qenë i punësuar në NSH deri në privatizim, e që ky pretendim nuk mbështet në prova, konkretisht nga arkivi i NSH-së del se ankuesi nuk ishte pjesë e listës së pagesave në gjashtë muajt e fundit para privatizimit. Ndër të tjera e paditura thekson se sa i përket librezës së punës që paditësi ka bashkangjitur në ankesë, ky dokument ka të bëjë vetëm me të drejtën e tij për përfshirje në listën e 20 %. E paditura thekson se ka vërtetuar se menaxhmenti i NSH-së nuk i ka "mbyllur" librezat e punës së punëtorëve kur ata në fakt kanë rreshtur së punuari për NSH-në. Për këtë arsye librezat e punës nuk vërtetohet se ankuesi ka punuar në NSH-në deri në privatizim. Si përfundim AL kërkon nga gjykata që ta refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 70.4 të shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-033. Në mbështetje të mbrojtjes e paditura dorëzoi dëshmitë në kopje si: Tabela 6.4 –Analiza e Rrogave të Papaguara të punëtorëve të NSH-së deri më 13 shtator 2011, Përmbledhjen Tremujore të Listës së Pagave (04.05.06/2010) dhe Përmbledhjen Tremujore të Listës së Pagave (07.08.09/2010).

Me 18 gusht 2014, gjykata lëshoi urdhër për paditësin me të cilin iu dorëzua mbrojtja e të paditurës për përgjigje. Me 22 gusht 2014, paditësi e pranoi mbrojtjen e të paditurës, mirëpo nuk paraqiti asnjë përgjigje.

Me 16 mars 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-13-1868, me të cilin ka aprovuar ankesën pjesërisht si të bazuar dhe ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRZ024 – 0021, të datë 26 gusht 2013. Ka obliguar të paditurën AKP, që paditësit S Anë emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, t'i paguaj shumën prej 1,260.00 € dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t'i paguaj shumën prej 126.00 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pa bazuar. Po ashtu ka vendosur që shumat e aprovuara do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Shkalla e parë ka arsyetuar se neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese).

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Tutja ka arsyetuar se sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle: 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore; 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore; 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore; 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore; 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;*

Shkala e I-rë ka vlerësuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se paditësi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH "FAMIPA", Prizren. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë paditësi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj dhe nëse NSH ka obligime ndaj paditësit si paga të papaguara apo çfarëdo obligimi në emër të kompensimit për shkëputje të parakohshme.

Paditësi pretendon se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit dhe kërkon nga gjykata që të aprovoj të gjitha kërkesat e tij dhe të obligohet e paditura t'ia paguaj pagat e papaguara si në përlogaritjet si në ankesë. E paditura i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke theksuar se neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, i jep të drejtë për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës vetëm atyre punonjësve të cilët janë pushuar nga puna si pasojë ose në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP, gjersa paditësi nuk ishte pjesë

e listës së pagave në gjashtë muajt e fundit para privatizimit të NSH-së dhe se kjo vërtetohet nga listat e pagave të dorëzuara nga e paditura. E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës dhe as lartësinë e kompensimit të pagave të kërkuara nga paditësi.

Paditësi, bazën e kërkesës e mbështet në librezën e punës, formularin për dorëzimin e kërkesës në procedurë të likuidimit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, datë 16 shtator 2011, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezat e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se paditësi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH "Famipa" prej 30 maj 1970 deri më 26 nëntor 1974 dhe përsëri prej 23 shkurt 1976 deri me 16 shtator 2011.

Shkalla e I-rë i ka pranuar si prova relevante librezën e punës dhe dëshmitë tjera mbështetëse, si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shtatë pagave mujore në shumë prej 180.00 €, në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme apo shumës totale prej 1,260.00 €, gjykata është bazuar në nenin 76.7.7.5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën që ka qenë në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, pagë të cilën e ka llogaritur vetë paditësi pranë AL dhe me rastin e parashtrimit të ankesës në gjykatë.

Shkalla e I-rë ka theksuar se një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.). Shkalla e parë e ka aprovuar shumën në lartësi prej 126.00 € në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Në lidhje me shumat e kërkuara përtej shumës së aprovuar siç janë: kërkesa në emër të pagave të punonjësve tre paga $3 \times 180 = 540.00$ € dhe kërkesa për pagat e papaguara për muajt: shkurt, mars, prill dhe maj të vitit 2011, në shumën prej 4×180 € e gjithashtu edhe për 15 ditë punë në muajin shtator të po atij viti, në shumën prej 137.14 €, shkalla e I-rë ka vlerësuar se kërkesat në fjalë janë jashtë kufijve të shqyrtimit të ankesës / vendimit të kundërshtuar të AL dhe si të tilla nuk mund të merren në shqyrtim.

Me 18 prill 2023, e paditura e dorëzon në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-13-1868 të datës 16 mars 2023, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN024-0021 i datës 26 gusht 2013. Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2004, prej kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Më 28 qershor 2024, Kolegji i Apelit ka leshur urdhër për paditësin në mënyrë që ai të mund të parashtrrojë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së, i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje deri në marrjen e këtij vendimi.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së parë i DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditesi më 27 qershor 2013 ka paraqitur kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së me të cilin ka kërkuar kompensim për ndërprerje të parakohshme të punës, por që AL me vendimin PRZ024-0021 të dt. 26 gusht 2013, kërkesën e tij e ka refuzuar si e pa vlefshme, me arsyetimin se paditesi nuk ishte punëtor aktiv në kohën e privatizimit të NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditesi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e parë, kërkesën e tij për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës e ka mbështetur me prova të mjaftueshme, duke dorëzuar përveç vendimit të Autoritetit të Likuidimit edhe Kërkesën për kompensimin e pagave, Formularin për dorëzimin e kërkesës në procedurë të likuidimit, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës nr. PRZ024/125 të datës 16 shtator 2011 si dhe librezën e punës.

Me këto dëshmi paditesi padyshim ka vërtetuar se ai kishte të drejtë që të i njihet e drejta e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën prej 1,260.00 euro, në bazë të përvojës së punës që ai e kishte në NSH.

Kolegji i Apelit vëren se paditesi në procedurën në Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka sjellë njoftimin zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 16 shtator 2011. Ky njoftim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Në bazë të këtij njoftimi, atë ditë është shitur Ndërmarrja në

bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë menjëherë. Në këtë njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësi duke u bazuar në këtë njoftim ka pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesë kërkesën për paga. Paditësi në afatin ligjor ka paraqitur kërkesën e tij tek Autoriteti i Likuidimit me datë 27 qershor 2013, andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar. Andaj pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit është parashkruar është pabazuar.

Prandaj duke u bazuar në provat e bashkangjitura, Shkalla e parë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, pasi që ai vendim nuk mbështetej në dispozita ligjore.

Nga këto arsye, ankesa e AKP-së është refuzuar si e pa bazuar, dhe është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë taksën gjyqësore për procedurën ankimore e ka paguar me datë 06 qershor 2023 në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
